

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"MEGI 2017" SHPK**

Sot me datën 01/06/2023 (dymijë e njëzet e tre), unë ortaku themelues :

- **Znj. Gjuliana Kalia**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 04 Prill 1997, lindur në Peshkopi dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Letërnjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J75404070P

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "MEGI 2017" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "MEGI 2017" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Rrugë Aleksandër Goga, Lagjja nr.6, Nr.Pasurie 1/291-N2, Volum 35, Zona Kadastrale 8513, Durrës

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Tregti të gjitha llojeve të materialeve elektrike, elektronike, hidraulike, telekomunikacioni, kompjuterike, kamera sigurie, pajisje alarmi. Shërbime kompjuterike, elektrike, elektronike, hidraulike, telekomunikacioni, kompjuterike, kamera sigurie, pajisje alarmi. Eksport-import të gjitha llojeve të materialeve elektrike, elektronike, hidraulike, telekomunikacioni, kompjuterike, kamera sigurie, pajisje alarmi, armature, suvatim, karpenteri, rikonstruksione godinash objektësh, ndërtim objektësh, shtrim pllakash, suvatime, lysterje patinim kapote, izolime tarracash, solete. Shitje material ndërtimi, pllaka, bojra me shumicë dhe pakicë. Import dhe eksport.

**NENI 4**

**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "MEGI 2017" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndarë si vijon:



**1. GJULIANA KALIA zotëron 1 kuotë baraz me 100% të kapitalit.**

**NENI 5**

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

**NENI 6**

**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **ZNJ.GJULIANA KALIA** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithëkompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**

**LKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"MEGI 2017" SH.P.K**

**GJULIANA KALIA**

Gjulianna Kalia 